



## Analizë e Raportit Vjetor 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

**Analizë e Raportit Vjetor 2017 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale  
(KPMM)**

**Autor: Bersant Beka**

Editoi: Dardan Abazi

---

"Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicërate për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së."

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka bërë analizimin e Raportit Vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për vitin 2017. Analizimi i raportit vjetor është pjesë e projektit “Promovimi dhe inkurajimi i bashkëpunimit në mes të hisedarëve si mjet për instalimin e praktikës demokratike në vendimmarrje” dhe programit të INDEP për Qeverisje Demokratike. Analizimi i raportit të KPMM-së si dhe raporteve të tjera bëhet duke konsideruar përgjegjësitë ligjore të Rregullatorit/Agjencisë, misionit që ka Rregullatori dhe standardeve minimale që rrjedhin nga Manuali për Raportim të Agjencive dhe Institucioneve të Pavarura.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është një nga Rregullatorët më të rëndësishëm në gamën e rregullatorëve dhe institucioneve të pavarura të Kosovës. Ai rregullon një nga sektorët të cilët Kosova është konsideruar vazhdimisht se ka një përparësi krahasuese. Fuqizimi dhe suksesi i rregullatorit, në këtë kuptim, nënkupton drejtëpërdrejtë edhe performancë më e mirë e shtetit në këtë sektor.

Mineralet dhe minierat e Kosovës janë pasuri kombëtare të mbojtura edhe me Kushtetutën e Vendit.

Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.<sup>1</sup>

Baza institucionale që rregullon këtë fushë ka një rëndësi shumë të madhe në ruajtjen e pasurisë nëntokësore dhe në përdorimin e saj në dobi të interesit publik dhe zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale mbetet instrumenti i vetëm me anë të së cilit Kuvendi informohet rreth punës së këtij rregullatori dhe në përgjithësi është një instrument matës i sektorit.

### Të gjetura nga raporti

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka përmbushur pothuaj të gjitha kërkesat që dalin nga Manuali për Raportim të Institucioneve të Pavarura. Kjo ka bërë që raporti të ketë informata të mjaftueshme në mënyrë që deputetët, qytetarët dhe investitorët potencial të kenë një pasqyrë fillestare të gjendjes së sektorit në përgjithësi dhe aktiviteteve të Rregullatorit për vitin 2017. Për këtë, INDEP përgëzon bordin dhe udhëheqjen e KPMM-së që ndër vite kanë treguar gatishmëri për të përmirësuar komunikimin me Kuvendin dhe kualitetin e raportimit.

Një risi që KPMM e ka shtuar në raportin e sivjemë është një “Analizë e problemeve në planifikimet vjetore në sektorin minerar” të cilën KPMM e ka shtuar në raportin e saj duke u bazuar në diskutimet dhe rekomandimet që edhe INDEP edhe Komisioni parlamentar i kishin identifikuar në vitet e kaluara. Kjo, jo vetëm që tregon konsistencë në raportin KPMM-Kuvend

---

<sup>1</sup> Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 122 – Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore, Prishtinë: GZRKS.

por edhe një përpjekje serioze të Rregullatorit për të plotësuar me informata raportin bazuar nga kërkesat që vinë nga vet Kuvendi i Kosovës vit pas viti. Sido qoftë, si edhe viteve të kaluara, edhe ky raport i KPMM-së ka hapësirë për t'u përmirësuar dhe ka disa elemente të cilat ka nevojë të sqarohen në diskutim në Komision.

## Licencimi

Në pjesën e licencimit ka një rënje shqetësuese të licencave të shfrytëzimit. Numri i licencave të shfrytëzimit të lëshuara gjatë vitit 2017 është vetëm 31. Kjo është më e vogël sesa në vitin 2012. Gjithashtu, për dallim nga viti 2016, numri i licencave të shfrytëzimit ka rënë për mbi 40% sepse në vitin 2016 ky numër ishte 53.




Figura 1. Numri i licencave të hulumtimit dhe shfrytëzimit të lëshuara ndër vite

Rënja e numrit të licencave, veçanërisht atyre të shfrytëzimit për dallim nga viti paraparak dhe vitet e tjera, konsiderojmë se është dashur të sqarohet më shumë. Cilat janë shkaqet që KPMM mendon se kanë qar deri tek kjo rënje dhe çka konsideron KPMM se duhet bërë që kjo të ndryshohet. Ose, nëse për sektorin dhe potencialet e tij kjo nuk paraqet ndonjë problem dhe është normale, edhe kjo duhet sqaruar tek pjesa e raportimit për numrin e licencave. Kjo, pa përjashtuar faktin se KPMM ka listuar sfidat e sektorit në përgjithësi.

## Transparenca dhe Web faqja

KPMM ka raportuar se ka shpenzuar pothuaj njëqind mijë euro në website të ri. Megjithatë, nuk ka një sqarim se si ka ndodhë ky ristrukturim, cilat janë mundësitë dhe të dhënat e reja që faqja ofron dhe çka pret KPMM se do të sjellë ky investim për të mirën e përgjithshme. Një element që duhet sqaruar e që nuk është sqaruar në raport është përse “Portali i të dhënave” në web faqe të KPMM-së nuk është i hapur për publikun pa pasur nevojë të krijosh llogari dhe të kyçesh me emër përdoruesi dhe fjalëkalim. Kjo duhet sqaruar në raport pasi baza e të dhënave është risia e vetme e madhe e web faqes së re dhe duhet sqaruar përse çasja në të kërkon gjithësesi një regjistrim llogarie paraparakisht.

## **Rekomandimet e Auditorit**

Një nga elementet e Manualit për Raportim të Institucioneve të Pavarura ka qenë edhe raportimi mbi statusin e implementimit të gjetjeve të Auditorit për vitin paraprak. Në këtë rast, KPMM, me këtë dokument raporton se a janë implementuar gjatë vitit 2017, gjetjet e raportit të Auditorit për vitin 2016. Kjo është paraparë në mënyrë që të ketë një ndërlidhje në mes të përmirësimit të performancës funksionale të Rregullatorit me atë financiare dhe që të dyja ta komplementojnë njëra tjetrën. Në raportin e sivjemë është raportuar se nga shtatë rekomandime të auditorit, pesë janë zbatuar dhe dy nuk janë zbatuar gjatë vitit 2017. Megjithatë, nuk ka një sqarim se përse këto dy rekomandime, që kanë të bëjnë me mbledhjen e borgjeve dhe gjobave nga operatorët e papërgjegjshëm nuk janë zbatuar.

INDEP konsideron që është shumë e rëndësishme që krahas deklaramit nëse janë zbatuar, të bëhet edhe një arsyetim në lidhje me atë se cilat janë arsyet që disa nga rekomandimet nuk janë zbatuar. Operimet ilegale vazhdojnë të jenë një sfidë për të gjithë sektorin për shkak të prishjes së konkurrencës së barabartë në treg, degradimit të skajshëm mjedisor dhe rritjes së ekonomisë informale. Këto rekomandime të auditorit kanë qenë shumë të rëndësishme pikërisht për të adresuar këtë problem dhe një sqarim më i detajuar përse s'janë zbatuar këto rekomandime, është i domosdoshëm.

## **Përfundime**

Raporti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017 plotëson në masë të madhe kërkesat nga Manuali për Raportim të Institucioneve të Pavarura dhe ofron një bazë mjaft të mirë të të dhënave për deputetët, qytetarët dhe investitorët e mundshëm në fushën e minierave dhe mineraleve. Disa elemente të raportit, megjithatë, ka nevojë të plotësohen me informata shtetë gjatë diskutimit në Komision.

Raportit i mungon një sqarim më i detajuar përse ka rënje të dukshme të licencave të shfrytëzimit për dallim me një vit më parë. Kjo për arsyen se ka viti 2017 ka shënuar një rënje prej 40% të numrit të licencave të shfrytëzimit të dhëna për dallim me një vit më parë dhe mund të jetë një tregues negativ për performancën e sektorit. Konsiderojmë që një informatë shtesë për këtë është shumë e rëndësishme për të njohur më drejtë problemin dhe zgjidhjet të cilat KPMM i sheh të nevojshme.

KPMM ka raportuar se kanë ridizajnuar webfaqen e re dhe për këtë kanë shpenzuar rreth njëqind mijë euro. Sidoqoftë, faqja e tanishme, në pjesën e bazës së të dhënave që është risia kryesore e saj, nuk ofron asnjë të dhënë pa u regjistruar me një përdorues dhe fjalëkalim. Kjo mund të mos jetë e lehtë për të gjithë përdoruesit dhe KPMM do të duhej të sqaronte më tepër këtë në raport.

Një tjetër e dhënë që mungon janë arsyet përse dy nga shtatë rekomandimet e Auditorit nuk janë adresuar nga ana e Rregullatorit. Konsiderojmë që është shumë e rëndësishme që krahas deklaramit “Jo” të jepet edhe një sqarim, po në atë tabelë se përse nuk janë zbatuar këto rekomandime. Marrë në tërësi, INDEP e vlerëson shumësinë e informatave të dhëna në raport dhe gatishmërinë e KPMM-së për të përmirësuar vit pas viti edhe më tutje raportin vjetor.



	c. Sfidat e vitit paraprak dhe planifikimi për vitin vijues	Deri diku			Mungojnë sfidat e vitit paraprak. Paraqiten vetëm sfidat për vitin 2017. Në këto sfida janë identifikuar përgjegjësit dhe janë dhënë rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren për t'u adresuar këto sfida. Planifikimet për vitin vijues janë specifike për secilën lëndë.
<b>6</b>	<b>Puna gjatë vitit paraprak</b>				
	a. Punet specifike që agjencia i ka bërë gjatë vitit raportues	Po			
	b. Detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjit	Po			
	c. Sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak (te arsyetohen ato që nuk janë arritur)		Jo		
<b>7</b>	<b>Raporti financiar</b>				
	a. Raporti i buxhetit me shpenzime	Po			
	b. Të ndahen rrogat nga mëditjet	Po			
	c. Ndikimi i buxhetit në punën e Institucionit	Jo			
	d. Planifikimi / Realizimi i buxhetit	Po			
	e. Investimet kapitale	Po			
	f. Tabelë krahasuese me buxhetin e tri viteve paraprake	Po			
	g. Shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve	Po			
	h. Vizitat jashtë vendit, mëditje, akomodim, numri I udhëtimeve dhe personave që kanë marrë pjesë	Po			Nuk jipen të dhëna për personat që kanë udhëtuar, por vetëm për numrin e personave.
<b>8</b>	<b>Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm</b>				
	a. Tabela duhet paraqitur me komentet dhe rekomandimet e ZAP dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre nga ana e institucionit	Po			Megjithatë nuk arsyetohet pse nuk është adresuar E gjetura 5/Rekomandimi 5.

<b>9</b>	<b>Anekset</b>				
	a. Të dhënat për vendimet dhe lëshimin e licencave	Po			
	b. Të dhëna shtesë për informatat e përgjithshme të shtjelluara në raport	Po			
<b>Specifikat e Raportimit</b>					
<b>10</b>	6.1.1 Licencat dhe lejet e lëshuara, transferuara, vazhduara dhe pezulluara të ndara në kategoritë në vijim: a. Licencat për hulumtim, b. Licencat për mbajtjen e të drejtave, c. Licencat për shfrytëzim, d. Licencat për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta, e. Licencat për shfrytëzimin zejtar dhe f. Licencat ose Lejet për interes të publikut.	Po			
<b>11</b>	6.1.2 Tabelë ku paraqitet gjendja në tre vitet e fundit për të dhënat e paraqitura më lartë.		Jo		
<b>13</b>	6.1.3 Listën për Rentat Minerare (përfshirë arkëtimin) për vitin përkatës dhe krahasimi me tre vitet e paraprake.		Jo		Jipen vetëm të hyrat nga renta minerare dhe krahasimi me tri vite paraprake.
<b>14</b>	6.1.4 Shqiptimi i Gjobjave Administrative.	Po			Vetëm numri i gjobjave të shqiptuara dhe inskasimi nga to.



---

"Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)."